ZEUS-AL

Bojra & Verniqe

ZEUSMETAL

BOJË ZMALTO E CILËSISË SË LARTË PËR METALE

PËRSHKRIMI TEKNIK

ZEUSMETAL është një produkt i veçantë me bazë solventi, i përshatshëm për t'u përdorur në zbukurimet e brendshme dhe të jashtme sikurse dhe në aplikimet mbrojtëse.
Ofron mbrojtje të shkëlqyer të sipërfaqeve metalike ndaj kushteve atmosferike dhe rrezeve ultra violet. Gjithashtu, është i përshtatshëm për mbrojtjen e sipërfaqeve zbukuruese prej druri. Produkti është i disponueshëm në 24 ngjyra te gatshme. Gjithashtu gjendet të gjitha ngjyrat e katalogut RAL dhe në një sërë nuancash që mund të përgatiten me sistemin ngjyrave **ZEUS-AL**.

CILËSITË

Është e fortë dhe mjaft rezistente ndaj goditjeve mekanike, kushteve të rënda atmosferike, pastrimit intensiv, përdorimit të gjatë dhe lagështisë. Ngjyra dhe niveli i shkëlqimit mbeten të pandryshuara për një periudhë të gjatë kohore. Gjithashtu, karakterizohet nga një elasticitet i lartë dhe si rrjedhim mund t'i rezistojë punimit të drurit.
Produkti mund të aplikohet shumë lehtë me furçë, rul ose pistoletë

FUSHA E APLIKIMIT

Përdoret për zbukurimin dhe mbrojtjen ndaj korrozionit të sipërfaqeve metalike, të cilat janë të ekspozuara në ambiente të rënda si ato detare, industriale, etj., si dhe në aplikime të tilla ku është e nevojshme mbrojtja ndaj korrozionit psh., makineritë, binarët, dyert metalike, anijet, pajisjet metalike, kangjellat, etj. Gjithashtu, mund të aplikohet edhe në lodrat prej druri si dhe në objektet zbukuruese prej druri dhe metali.

VOC (Përbërësit e Paqëndrueshëm Organik)
Vlera limit e BE: për këtë kategori produkti A/i (Bojra specifike me një komponent): 600g/l (2007) dhe 500g/l (2010).
Ky produkt përmban maksimalisht 480 g/l VOC.

ZEUS - AL Adresa: L.14, Rr. "Asti Gogoli", ish NPA, Shkozet - Durrës
Tel: +355 52 265 461 / E-mail: info@zeus-al.com
web: www.zeus-al.com

ZEUSMETAL

BOJË ZMALTO E CILËSISË SË LARTË PËR METALE

APLIKIMI

Sipërfaqja që dëshirojmë të lyejmë duhet të jetë e pastër dhe e thatë,pa praninë e yndyrnave,pluhurave,ndryshkut dhe kripërave.
Hollimi për furçë ose rul: 5-10% sipas peshës, me BRUSH SOLVENT No 100 të **ZEUS-AL**.
Hollimi për furçë ose rul: 5-10% sipas peshës, me SPRAY SOLVENT No 200 të **ZEUS-AL**.
Aplikimi: Aplikoni 1-2 shtresa mbi sipërfaqen e pastruar mirë.
Për një performancë më të mirë mbrojtëse ndaj korrozionit, sugjerohet të aplikohen fillimisht 1-2 shtresa RUST PRIMER të **ZEUS-AL**.
Për sipërfaqe alumini ose të xinguara: Aplikoni fillimisht 1-2 shtresa WASH PRIMER të ZEUS-AL.
Për një nivel më të lartë fortësie, përdorni HARDENER të **ZEUS-AL** në një masë 10-15% sipas peshës. Përzierja duhet të përdoret deri në 8 orë.
Temperatura e aplikimit: 5 - 35°C

TË DHËNA TEKNIKE

Ngjyra: E bardhë & ngjyra.
Shkëlqimi, në 60°: 85±5 (ELOT EN ISO 2813-99)
Densiteti: 0.95 – 1.20± 0.01 gr/ml në varësi të ngjyrës. (EN ISO 2811.01-02, 20°C)
Viskoziteti: DIN 6, në 25° C: 60-80 sec (ISO 2884.02-03)
Viskoziteti në aplikim me pistoletë 4 mm: 18-22 sec(ISO 2884.02-03)
Substanca të ngurta, sipas peshës, %: 62±2 (ELOT EN ISO 3251-03)
Koha e tharjes në 25° C:
- Tharja në sipërfaqe: 20-35 min
- Tharja në prekje: 2-3 orë
- Tharja në brëndësi: 16 orë
- Rilyerja: pas 16-24 orë

Pika e ndezjes: 26° C (ELOT EN ISO 1523-02)
Ngjitja në metal (ndër-prerë): 0-1 (ELOT EN ISO 2409-95)
Ngjitja në WASH PRIMER (ndër-prerë): 0-1 (ELOT EN ISO 2409-95)
Fortësia (Köning): 55 ±5 pas 7 ditësh (ELOT EN ISO 1522-00)
Elasticiteti (testi i Mandrel): 3±1 mm pass (ELOT EN ISO 1519-02)
Mbulimi: 13-15 m²/lit për shtresë në sipërfaqet e përgatitura më parë dhe në varësi të ngjyrës.

PËR APLIKIM ME PISTOLETË:
Përdoreni gjithmonë në ambiente të ajrosura mirë duke përdorur maskë dhe doreza të përshtatshme për mbrojtje.
Mos i thithni avujt.

ZEUS - AL Adresa: L.14, Rr. "Asti Gogoli", ish NPA, Shkozet - Durrës
Tel: +355 52 265 461 / E-mail: info@zeus-al.com
web: www.zeus-al.com